

I.T.E. GRUP Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(me raportin e Audituesit të Pavarur)

A handwritten signature in black ink, located in the bottom right corner of the page. The signature is stylized and appears to be a personal name.

Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE

BILANCI	5-6
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	7
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	8
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT AKSIONER	9
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	10-18



ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

1. Të përgjithshme

"ITE Grup" është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 16/01/2001 në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare" dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numrin e identifikimit K11323001H.

Selia ligjore e shoqërisë është në adresën: Rruga dytësore, autostrada Tiranë- Durrës, km 5, Tiranë.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 500.000.000,00 Lek. Ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë është Z. Sokol Zotkaj, zotërues i 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Shoqëria ka për objekt aktivitetin import-eksport dhe tregtimin e të gjitha llojeve të materialeve, makinerive paisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit elektrik, elektroshtëpiak, elektronik, të telekomunikacionit, të destinuara për objekte civile dhe industriale.

2. Deklarata e përputhshmërise

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

3. Përmbledhëse e politikave te rëndësishme kontabël

(a) Të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe në përputhje me Standartet Shqiptare të Kontabilitetit. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK Shqiptar ("LEK") që është monedha raportuese e shoqërisë.

(b) Të ardhurat

Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmeri, të ardhurat me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmeri;
- ii. Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- iii. Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- iv. Shpenzimet e bëra për shërbimin në datën e bilancit , si dhe ato që do te bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

(c) Vlerësimi i likuiditeteve

Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse në bankë në lekë dhe në monedha të huaja.

ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

(d) Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin e këmbimit në datën që bëhen transaksionet. Të ardhurat dhe humbjet nga kurset e këmbimit, që vijnë për shkak të shlyerjeve të këtyre transaksioneve dhe të rivlersimit të aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të periudhës, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit sipas bankës së shqipërisë të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare (lek kundrejt monedhës perkatëse) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	2019	2018
EUR	121.77	123.42
USD	108.64	107.82

(e) Aktivet afatgjata materiale**i. Njohja dhe matja**

Aktivët afatgjatë materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlersimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e caktuar, kostot e cmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjëndjen e mëparshme.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato stabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjatë materiale.

ii. Kostot në vijim.

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjatë njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas legjislacionit shqiptar duke përdorur metodën lineare të amortizimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit të zbatuara sipas kategorive të aktiveve kryesore janë si më poshtë:

	%
Ndërtesa	5
Instalime teknike dhe mobilje	20
Mjete transporti	20
Pajisje zyre	25

ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

(f) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin aktual është bazuar në shumën e tatimit të pritshëm për tu paguar llogaritur sipas legjislacionit Shqiptar si dhe përcaktimeve në rregullat bazë kontabël në Shqipëri duke përdorur normën e tatimit të zbatueshëm në datën e hartimit të Pasqyrave si dhe çdo rregullim për tatim fitimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Përqindja e tatimit në fuqi gjatë vitit 2019 ishte në masën 15%

(g) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten me vlerën neto të realizueshme, që është kosto minus provigjionin për llogaritë e dyshimta.

(h) Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investimet afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi deri në tre muaj, që janë lehtësisht të konvertueshme në një shumë të njohur mjetesh monetare dhe nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë.

(i) Furnitorë dhe detyrime të tjera

Furnitorët dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto.

(j) Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Banka Euro	165,683	270,669
Banka Leke	3,667,647	7,401,255
Banka Dollar	24,549	26,919
Total banka	3,857,879	7,698,843
Arka Leke	3,904,693	295,055
Arka Euro	1,047,140	804,779
Arka ne USD	91,220	11,822
Total arka	5,043,053	1,111,656
Total mjete monetare	8,900,932	8,810,499

5. Klientë për mallra, produkte e shërbime

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të paarkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare. Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Kliente per arketim	663,147,008	647,032,743
Totali	663,147,008	647,032,743

ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

6. Llogari të tjera të arkëtueshme

Gjendja e llogarive të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Tvsh e zbritshme	-	1,796,419
Tatimi mbi fitimin	43,347	-
Financime ne shoqerite e kontrolluara	-	3,500,000
Hua te tjera te arketueshme	22,055,090	5,333,225
Llogari ne dogane	19,710	37,992
Parapagime te dhena	21,015,641	964,629
Totali	43,133,788	11,632,265

7. Inventar

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Mallra per rishitje	287,779,951	246,714,301
Totali	287,779,951	246,714,301

8. Shpenzime te shtyra

Gjendja e shpenzimeve te shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Depozite garancie per qera	325,000	-
Shpenzime per tu shperndare	2,259,156	-
Totali	2,584,156	-

9. Investime afatgjata

Gjendja e kuotave të shoqërive të kontrolluara më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Pjesemarrje ne kapital te shoqerive te kontrolluara	1,123,050	1,000,000
Totali	1,123,050	1,000,000



ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

10. Aktive afatgjata materiale

	Ndertesa	Pajisje Informatike	Mjete Transporti	Instalime teknike dhe mobilje	Total
Vlera historike					
Më 1 Janar 2019	318,702,579	12,161,247	42,924,884	33,071,060	406,859,770
Shtesa	-	5,960,709	14,766,474	3,338,696	24,065,879
Pakësime	-	-	(4,004,058)	-	(4,004,058)
Më 31 Dhjetor 2019	318,702,579	18,121,956	53,687,300	36,409,756	426,921,591
Amortizimi i akumuluar					
Më 1 Janar 2019	72,096,599	11,704,098	7,700,848	15,504,747	107,006,292
Shpenzimi i vitit	12,330,299	980,027	4,834,929	4,423,068	22,568,323
Më 31 Dhjetor 2019	84,426,898	12,684,125	12,535,777	16,022,817	129,574,615
Vlera kontabël, neto					
Më 1 Janar 2019	246,605,980	457,149	35,224,036	17,566,313	299,853,478
Më 31 Dhjetor 2019	234,275,681	5,437,831	41,151,523	20,386,930	301,251,965

ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

11. Hua bankare

Gjendja e huave bankare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Hua afatshkurtra (overdraft bankar)	140,015,833	141,071,049
Totali	140,015,833	141,071,049

12. Llogari të pagueshme

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve. Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Furnitore	333,744,999	354,111,476
Totali	333,744,999	354,111,476

13. Llogari të pagueshme per punonjesit

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj punemarresve. Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Pagat e punonjesve	2,719,223	2,261,567
Sigurime shoqerore & shendetsore	1,271,416	1,079,594
Totali	3,990,639	3,341,161

14. Detyrime tatimore

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Tatim ne burim	26,100	26,100
Tatim fitim per tu paguar	-	2,818,672
Tatim mbi vleren e shtuar (Tvsh)	252,000	-
Totali	278,100	2,844,772

15. Hua bankare

Gjendja e huave bankare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

Detyrime afatgjata	31/12/2019	31/12/2018
Hua bankare afatgjate	144,830,056	109,763,309
Totali	144,830,056	109,763,309

ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

16. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Detyrime ndaj ortakut	8,892,019	31,738,569
Dividente për t'u paguar	18,032,432	6,023,283
Totali	26,924,451	37,761,852

17. Të ardhurat nga shitja

Shitjet neto 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Shitje e mallrave e shërbimeve	1,138,256,540	1,013,738,774
Totali	1,138,256,540	1,013,738,774

18. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

Te ardhura te tjera te shfrytezimit ne 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Shitja e AAGJ materiale	1,175,000	2,076,000
Te ardhura te tjera financiare	11,596,886	4,219,851
Totali	12,771,886	6,295,851

19. Materiale dhe Shërbime të konsumuara

Materiale dhe Shërbime të konsumuara më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Kosto e mallrave të shitura	935,013,641	817,610,013
Totali	935,013,641	817,610,013

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Shpenzime për pagat	36,925,262	33,827,843
Shpenzime për sigurimet shoq.&shendet.	5,815,517	5,316,099
Totali	42,740,779	39,143,942

ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Shpenzime energji elektrike	2,377,626	1,764,536
Shpenzime kancelarie	366,372	273,208
Shpenzime konsulence	1,301,921	600,000
Shpenzime IT	1,043,975	543,375
Qira	2,460,000	2,460,000
Mirembajtje dhe Pastrime	1,155,912	1,895,584
Shpenzime Mirembajtje Mjete	1,782,966	1,878,051
Shpenzime per polica sigurimi	1,093,213	1,430,793
Shpenzime Sigurimi Roje	1,732,370	1,711,370
Shpenzime noteriale	178,950	444,940
Publicitet, reklama	516,046	21,000
Dieta personeli	3,081,638	2,887,808
Shpenzime personeli	1,135,108	587,455
Shpz.postare e telekom.	1,154,336	1,215,801
Shpenzime transporti	4,136,839	21,951,034
Sherbime bankare	1,606,478	1,752,160
Skaneri dogane	16,771	757,201
Taksa dhe tarifa vendore	758,714	1,273,457
Tatime te tjera	75,450	7,179,177
Vlera kontabel e AQ te shitura	99,066	-
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	800,288	1,230,732
Shpenzime per koncesione, patenta, licenca	570,468	542,005
Shpenzime te tjera	274,173	379,906
Shpenzime te Agjencive Doganore	-	1,494,953
Shpenzime te tjera	57,954	48,364
Totali	27,776,634	54,322,910

22. Shpenzimet e interesit

Shpenzimet e interesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Te ardhura nga interesi	10,390	283
Shpenzime per interesa	11,415,519	10,459,360
Totali	(11,405,129)	(10,459,077)

23. Diferenca nga kurset e këmbimit

Të ardhurat nga diferencat e kurseve të këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31/12/2019	31/12/2018
Fitim nga kembimet valutore	20,570,695	31,129,610
Humbje nga kembimet valutore	7,006,079	1,768,920
Totali	13,564,616	29,360,690

ITE GRUP SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019

(Vlerat në Leke)

24. Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri.

Tatimi mbi fitimin është i pagueshëm në normën 15% bazuar mbi fitimin neto për periudhën dhe nuk korrigjohen për efekte tatimore në përputhje me legjislacionin shqiptar tatimor. Deklarimi dhe pagesa e detyrimit të tatimit mbi fitimin bëhet cdo vit pranë autoriteteve tatimore, por fitimi dhe humbja fiskale mbeten të përlogaritura derisa të kontrollohen nga këto autoritetet tatimore.

	31/12/2019	31/12/2018
Fitimi (humbja) para tatimit	125,088,534	105,357,944
Fitim i periudhes	125,088,534	105,357,944
Shpenzime te panjohura si me poshte:	12,122	5,524
Shpenzime per pritje, percjellje	-	-
Penalitete, gjoba e demshperblime	12,122	5,524
Dhurata	-	-
Shpenzime te viteve te kaluara	-	-
Humbje nga mosarketimet e klienteve	-	-
Shpenz. te tjera pa dok. tat. te rregullta	-	-
Fitimi Fiskal	125,100,656	105,363,468
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Shpenzimet per tatim fitimin (15%)	18,765,098	15,804,520

25. Angazhime e detyrime të mundshme

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2019 shoqëria nuk ka angazhime kapitale e detyrime të mundshme që kërkojnë paraqitje në pasqyrat financiare.

26. Ngjarjet pas datës së bilancit

Asnjë ngjarje e rëndësishme e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

Emri i Shoqerise: ITE Group Shpk

Adresa: Rruga dytësore, autostrada Tiranë- Durrës, km 5, Tiranë

NIPT: K11323001H

DEKLARATE

Deklaroj se shoqeria "ITE Grup" Shpk ka hartuar pasqyrat financiare te vitit 2019 konform Standarteve Kombetare te Kontabilitetit.

Hartuesi i pasqyrave financiare eshte:

"Shoqeria ZLA Consulting shpk" (studio kontabiliteti) me NIPT L82231012A.

28 Mars 2020

ITE Grup Shpk

Sokol Zotkaj

Sokol Zotkaj

ZLA Consulting Shpk

Bledar Korkaj

